

**LIGJ**  
**Nr. 7613, datë 28.9.1992**

**PËR MIRATIMIN ME NJË NDRYSHIM TË DEKRETIT NR.255, DATË 17.7.1992 “PËR  
DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1874, DATË 7.6.1954 “MBI SHTETËSINË  
SHQIPTARE””**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Të miratohet dekreti nr.255, datë 17.7.1992 "Për disa plotësime në dekretin nr.1874, datë 7.6.1954 "Mbi shtetësinë shqiptare"", me këtë ndryshim:

Në nenin 1, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Personat që do të rezultojnë me më shumë se një shtetësi, si pasojë e zbatimit të këtij dekreti, do të gëzojnë të drejtat dhe do të përmbushin detyrat që parashikohen nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë".

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.319, datë 13.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**

Fletorja Zyrtare: Viti 1992, Nr 6, Faqe 319; Data e botimit: 02-12-1992;